

A K T - T H E M E L I M I
(K O N T R A T Ë)
P Ë R
T H E M E L I M I N E S H O Q Ë R I S Ë T R E G T A R E M E
P Ë R G J E G J Ë S I T Ë K U F I Z U A R
“EIGHTH DAY” SH.P.K

Bazuar në ligjin 9901 dt 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar nëpërmjet Ligjit 129/2014 datë 02.10.2014, dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë fushën e regjistrimit, liçensimit dhe funksionimit të subjekteve tregtare në Republikën e Shqipërisë, në Romë, Itali, sot, më datë 21.10.2024, shtetasia Italiane, Sofia Zhu, e bija e Huanchi Zhu, lindur në Empoli (FI), më 08/12/1995 dhe banuese në Itali, shtetasia Italiane, mbajtëse e pasaportes Italiane me ID: YC6985579, madhore e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, dhe shtetasia Zhengao Ma e bija e Changchun Ma, lindur në Zhejiang Kinë, më 19.01.1997 dhe banuese në Itali, shtetasia Kineze, mbajtëse e pasaportes Kineze, ID: E99973525, madhore e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, si dhe shtetasia Zhengyue Ma e bija e Changchun Ma, lindur në Zhejiang Kinë, më 20.01.1990 dhe banuese në Itali, shtetasia Kineze, mbajtëse e pasaportes Kineze, ID: E83054114, madhore e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me vullnetin e tyre të lirë në cilësinë e ortakëve themelues, pasi themeluan shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar **“EIGHTH DAY” sh.p.k** shpallin edhe statutin e shoqërisë tregtare si më poshtë vijon:




FORMIMI
Neni 1

Formohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **“EIGHTH DAY” sh.p.k** me tre ortakë themelues:

- Sofia Zhu lindur në Empoli (FI) Itali, më 08.12.1995 dhe banuese në Itali, shtetasia Italiane, mbajtës e pasaportes Italiane me ID: YC6985579,
- Zhengao Ma, lindur në Zhejiang Kinë më 19.01.1997 dhe banuese në Itali, shtetasia Kineze, mbajtëse e pasaportës Kineze me ID: E99973525
- Zhengyue Ma lindur në Zhejiang Kinë, më 20.01.1990 dhe banues në Itali, shtetasia Kineze, mbajtëse e pasaportës Kineze me ID: E83054114

Neni 2

Shoqëria tregtare **“EIGHTH DAY” sh.p.k** do ta ketë selinë e saj në: Njësia Administrative Nr.1, Rruga “Pasho Hysa”, Z.K 8180, Kodi Unik i pasurise 8180050012, Tiranë.



Veprimtaria e saj do të jetë me kohë të pacaktuar.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj ekonomike në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe në cdo shtet tjetër të huaj, me miratimin e asamblesë së përgjithshme të ortakëve dhe në përputhje me ligjet e vendit apo shtetit përkatës ku do ta ushtrojë këtë veprimtari, duke zbatuar të gjitha dispozitat ligjore të vendit ku do të ushtrojë veprimtarinë e saj.

Neni 3

Shoqëria është person juridik shqiptar.

Veprimtaria e saj zhvillohet sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar, sipas kësaj kontrate dhe statutit të shoqërisë të cilat janë akte ligjore të ta pandashme.

Shoqëria është me përgjegjësi të kufizuar dhe përgjigjet vetëm për pasurinë e saj dhe në asnjë rast nuk përgjigjet për detyrimet e ortakut/ortakëve jashtë kushteve të kësaj kontrate. Gjithashtu dhe ortakët nuk përgjigjen personalisht për detyrimet e shoqërisë dhe nuk ngarkohen në asnjë rast për detyrimet jashtë kuotës së tyre në krijimin e shoqërisë, apo asaj që do të posedojnë në të ardhmen, përveç rasteve kur ai/ata vullnetarisht marrin përsipër për një gjë të tillë.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë tregtare **“EIGHTH DAY” sh.p.k** është:

- Tregëti me pakicë e artikujve industrialë, ushqimorë, blektoralë dhe bujqësorë. Tregëti me pakicë të artikujve të ndryshëm shtëpiake. Import, Export. Shitje online të mallrave dhe shërbimeve të ndryshme.

Veç sa më sipër në shoqëri do të zhvillohet çdo aktivitet tjetër që vetëm ose së bashku me veprimtarinë kryesore të lartpërmendur, do të vlerësohen si të favorshme për zhvillimin, forcimin dhe rritjen e gjendjes ekonomike e financiare të saj.

Neni 5

Kapitali themelor i shoqërisë është caktuar në shumën 100 lekë dhe përbëhet nga 3 kuota me vlerën e tyre nominale totale prej 100 lekë, dhe të ndara si më poshtë:

Kapitali themelor, kontribuohet prej ortakëve themelues, dhe u takon ortakëve si më poshtë:

- Ortaku, Sofia Zhu kontribuon, dhe posedon 1 kuotë me vlerë nominale 34 lekë,
- Ortaku, Zhengao Ma kontribuon, dhe posedon 1 kuotë me vlerë nominale 33 lekë,
- Ortaku, Zhengyue Ma kontribuon, dhe posedon 1 kuotë me vlerë nominale 33 lekë,

Ortakët e shoqërisë do të derdhin në arkë apo llogaritë bankare të saj, shumën e përcaktuar më sipër, brenda 90 ditëve nga data e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar pranë QKB.

Neni 6

Shoqëria fillon veprimtarinë e saj tregtare pas rregjistrimit të saj si person juridik dhe në rregjistrin tregtar pranë QKB.

Të ardhurat neto pas veçimit të fondeve si më sipër dhe shlyerjes së detyrimeve fiskale i mbeten për përdorim ortakëve të shoqërisë të cilët i ndajnë midis tyre në përputhje me vendimin e Asamblesë së ortakëve për caktimin e fitimeve.

Vendimi për caktimin e fitimeve (për shpërndarjen e fitimeve, për caktimin e rezervave apo mosshpërndarjen e fitimeve të vitit ushtrimor apo dhe fitimeve të mbartura), do të merret në çdo rast në mbledhjen përkatëse të asamblese së ortakëve të shoqërisë, me miratimin në mënyrë unanime me 100% të të gjithë kuotave të shoqërisë.

Asambleja e ortakëve mund të vendosë që të shpërndahen shumat e fondeve të rezervuara duke treguar shprehimisht llojin e reserves ku janë marrë.

Fitimet neto të realizuara nga veprimtaria e shoqërisë si dhe shumat e fondeve të rezervuara, do të përdoren lirisht nga ortakët/ortaku i saj. Ortakët/ortaku do t'i disponojnë lirisht fitimet neto të shoqërisë si dhe shumat e fondeve të rezervuara, pas vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, për shpërndarjen e tyre. Ortakët e shoqërisë nëpërmjet vullnetit të tyre të shprehur me shkrim, janë autoriteti i vetëm ligjor apo ekzekutiv, që vendos dhe vepron, në lidhje me caktimin e fitimeve neto të shoqërisë apo shumave të fondeve të rezervuara, për shpërndarjen ose jo të tyre, për investimin ose jo të tyre, si dhe për mënyrën e ndarjes së tyre midis ortakëve të shoqërisë.

Në çdo rast, dhe rast pas rasti, fitimet neto të shoqërisë apo shumat e fondeve të rezervuara, do të shpërndahen midis ortakëve të saj, në raportet që ortakët e shoqërisë, do të miratojnë në mënyrë unanime, me 100% të kotave të kapitalit të shoqërisë, pas analizave vjetore të aktivitetit tregtar dhe financiar të shoqërisë duke marrë në konsideratë edhe performancën e ortakëve në funksion të realizimit të fitimeve të shoqërisë, pavarësisht raportit të kuotave që ortakët kanë apo do të kenë në të ardhmen në shoqëri.

Ortakët e shoqërisë, nëpërmjet këtij statuti të shoqërisë, japin miratimin e tyre të plotë dhe të parevokueshëm, për mënyrën e ndarjes së fitimit neto të saj, të përcaktuar si më sipër në këtë nen, duke hequr dorë dhe njëkohësisht duke humbur çdo të drejtë të tashme dhe të ardhme, për të pretenduar ndryshe nga sa është përcaktuar në të.

Cdo ortak ka të drejtën e transferimit jashtë vendit të pjesës së fitimit duke zbatuar dispozitat ligjore për këtë transferim.

Neni 7

Organet drejtuese të shoqërisë janë: **Asambleja e Pergjithshme & Administratori**. Asambleja e shoqërisë përbëhet nga Ortakët e saj. Administrator i shoqërisë është Zj. Sofia Zhu.

Për aplikimin e këtij Akti Themelimi dhe Statuti të shoqërisë sonë pranë QKB, me qëllim rregjistrimin e shoqërisë për herë të parë, në mungesë të pajisjes me nënshkrim elektronik të administratores së shoqërisë Znj. Sofia Zhu pasi është shtetase e huaj, autorizojmë në mënyrë unanime studion e kontabilitetit: Top Financë Consulting Company, me NIPT: L31420014G, me përfaqësues ligjor Zj. Almeta Korçari, që të kryejë aplikimin për rregjistrimin e shoqërisë sonë në rregjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë që administrohet nga QKB dhe njëkohësisht dhe aplikimin e rregjistrimit të pronarëve përfitues të shoqërisë në rregjistrin e pronarëve përfitues të subjekteve juridike.

Studio e kontabilitetit: Top Financë Consulting Company, nëpërmjet përfaqësuesve të saj, do të kryejë vetëm procedurën e aplikimit teknik, në platformën elektronike e-albania, për llogari të shoqërisë sonë, dhe në cdo rrethanë dhe për çdo rast, këto aplikime janë plotësisht vetëm nën përgjegjësinë ligjore të shoqërisë sonë dhe të ortakëve të saj, sa i takon vullnetit të ortakëve themelues dhe vërtetësisë së përmbajtjes së dokumentacioneve të dorëzuara elektronikisht, për rregjistrimin e shoqërisë për herë të parë në QKB dhe njëkohësisht të pronarëve përfitues të shoqërisë në rregjistrin e pronarëve përfitues të subjekteve juridike.

Mënyra e formimit dhe funksionimi i këtyre organeve përcaktohen me statutin e shoqërisë.

Neni 8

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë karakterin e fshehtësisë të gjithë dokumentacionit, informatave, etj. Duhet të merren masa të plota për të shmangur përhapjen e cdo të dhëne që ka të bëjë me shoqërinë dhe që vlerësohet si sekret tregtar në bazë të dispozitave ligjore në fuqi në vendin e ushtrimit të aktivitetit.

Neni 9

Shoqëria mund të kryejë cdo veprim juridik që ka të bëjë me objektin e veprimtarisë së saj.

Neni 10

Kjo kontratë lidhet për një periudhë kohe të pacaktuar. Ky afat mund të ndryshojë me vendim të organit kompetent në përputhje me statutin e shoqërisë dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 11

Dispozita të hollësishme për shoqërinë dhe funksionimin e saj përcaktohen në statutin e shoqërisë që i bashkangjitet dhe është pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

Mosmarveshjet që mund të lindin midis palëve në se nuk gjejnë zgjidhje me bisedime e mirëkuptim, do të zgjidhen në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë.

Neni 12

Kjo kontratë u përpilua në katër kopje të njëjta në gjuhën shqipe duke depozituar kopjen në QKB për kryerjen e procedurave të rregjistrimit në Rregjistrin Tregtar pranë saj, si dhe në cdo organ që kërkohet sipas ligjeve në fuqi.

Tiranë më, 21 Tetor 2024.

ORTAKËT THEMELUES:

EIGHTH DAY

Sofia Zhu

SOFIA ZHU *Sofia Zhu*

Zhengao Ma

MA ZHENGGAO *Ma Zhengao*

Zhengyue Ma

MA ZHENGYUE *Ma Zhengyue*